

TEKNOLOGJI NË BIZNES - VITI I DYTË- SEMESTRI III

Bazat e Menaxhmentit (O): 7 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të përfitojnë njohuritë e nevojshme nga bazat e menaxhimit, përkatësisht menaxhmentit si aktivitet, i cili realizohet me ndihmën e funksioneve themelore në arritjen e qëllimeve të organizatës: kuptimi i parimeve themelore mbi të cilat zhvillohet dhe funksionon menaxhimi, kuptimi i ndërveprimit të menaxhimit me veprimtaritë tjera, mënyrën bashkëkohore të menaxhimit, aplikimi i njohurive themelore për analizën, planifikimin, organizimin, menaxhimin dhe kontrollin e zhvillimit në praktikë, zgjidhjen e problemeve konkrete në ekonomi dhe biznes.

Bazat e Marketingut (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të pajisen me njohuritë për marketingun. Përcaktimi i bazave të marketingut dhe shpjegimeve të tendencave teorike dhe metodike, pse ekziston një sistem marketingu. Përshkrimi i organizimit të marketingut në përgjithësi, instrumentet kryesore dhe natyrën e marketingut në përgjithësi. Aftësimin e studentëve në shpjegimin e fenomeneve të tilla, si: shtimin e vlerës së produkteve në lidhje me kohën, formën, vendin, dhe lehtësirat për zotërim. Aftësimin e studentëve në vlerësimin e faktorëve kyç, që veprojnë në organizimin dhe performancën e sistemit të marketingut dhe të kuptimit sa më në thellësi të historisë së zhvillimit të vetë këtij lloji marketingu, etj.

Dizajnimi dhe Administrimi i Bazës së të Dhënave (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentëve t'u ofrojë materiale e shpjegime të zgjeruara, sa i përket krijimit të bazave të të dhënave relacionale dhe elementet përbërëse të tij. Rëndësi të veçantë, të vendosur në krijimin e tabelave, pyetësorëve dhe ER-diagramet. Në fund të kapitujve, shpjegime më të thella të dhëna, në lidhje me SQL dhe transaksionet.

Zhvillimi i Aplikacioneve Biznesore (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të fitojnë njohuri bazike dhe konceptimin e procesit të krijimit të aplikacioneve softuerike për biznes. Njohja me hapat dhe masat që duhet të ndërmerren për zhvillimin e sistemeve softuerike me kosto efektive dhe të kualitetit sa më të lartë.

E- Qeverisja (Z): 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, njohja e studentëve me E-Qeverisjen dhe efektin që ka ajo në biznes, me të cilën do të zhvillohen informatat e bazuara në webaplikacione. Lënda "E-Qeverisja", fokusohet më tepër në qeverisjen elektronike të aplikacioneve, teknologjive dhe mjeteve që nevojiten për të drejtuar biznese në WWW(World Wide Web). Shqyrtohen fondacione të E-qeverisjes, infrastrukturës së saj, modelit të tanishëm të biznesit në transaksionet biznes drejt klientit dhe biznes drejt biznesit, sigurimi dhe kualiteti, strategjitë e web-dizajnit, marketingu i bazuar në web, problemet e zhvillimit të aplikacioneve, marrëdhënia klient -menaxher dhe web celularët.

Sistemet e informacionit në biznes [Z]: 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri mbi sistemin e informacionit, ndërtimi dhe dizajnimin e këtij sistemi, infrastrukturën përbërëse të saj, implementimin e sistemit të informacionit në fushën e ekonomisë, veçanërisht në proceset biznesore. Të njohohen me implikimet që i ka sistemit në punët zinxhirore menaxheriale të një biznesi etj.

E Drejta në TI [Z]: 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lëndë është që studentët të njohohen me të drejtat personale dhe organizative në fushën e Teknologjisë Informative, e drejta e aplikimit të aplikacioneve softuerike në fushën e biznesit, të drejtat e autorit, të drejtat e publikimit të informacionit, autorësisë dhe privatësisë së informacioneve personale, të drejtat e pronësisë intelektuale në aspektin e teknologjisë informative.

TEKNOLOGJI NË BIZNES - VITI I PARË- SEMESTRI II

Zhvillimi i Ndërmarrësisë dhe Menaxhimi NMV-ve (O): 7 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të përfitojnë njohuri të nevojshme të zhvillimit të shkencës dhe koncepteve të ndërmarrësisë, zhvillimi i ideve ndërmarrëse, të kuptuarit dhe definimin e ndërvarësisë, analizimi i mjedisit për mundësitë ndërmarrëse, hartimi i planeve të biznesit, formimi i aftësive dhe shkathtësive për të planifikuar, gjeneruar dhe menaxhuar bizneset, zhvillimi i biznesit të vogël dhe të mesëm në Kosovë, biznesi ndërkombëtar etj. Të përfitojnë njohuritë e nevojshme nga: konceptet themelore të ndërmarrësisë, zhvillimin e ideve ndërmarrëse, analizimin e mjedisit për mundësitë ndërmarrëse, të hartojë dhe zbatojë planet e biznesit, të fillojë dhe menaxhojë një biznes, mundësitë e biznesit ndërkombëtar, mundësitë e zhvillimit të biznesit të vogël dhe të mesëm në Kosovë.

Teoria dhe Sjellja Organizative (O): 5 ECTS

Lënda Sjellja Organizative, studentëve ju ofron njohuri teorike nga fusha e aplikimit dhe e organizimit të mundësive organizative në ndërmarrjen ekonomike, me theks të veçantë në afarizmin bashkëkohor. Përfitimi i njohurive të nevojshme të avancuara në lëmin e sjelljeve organizative dhe menaxhimin e ndërmarrjes.

Shkenca, Teknologjia dhe Inovacioni (O): 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët t'i njohë me të rejtat e fundit nga fusha e teknologjisë dhe e shkencës dhe mënyrën se si vetë ata mund të kontribuojnë në këtë drejtim. Inovacioni në teknologji dhe shkencë sjell, zhvillime të mëdha në ekonomi dhe përparimin e shteteve përkatëse. Në kuadër të kursit, studiohen të gjithë faktorët që mundësojnë zhvillimet në biznes dhe fushat të cilat e përkrahin me të madhe teknologjinë inovative për zhvillimin e tyre.

Komunikimi i të Dhënave në Biznes (O): 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me nevojën dhe domosdoshmërinë e menaxhimit të të dhënave të deponuara në bazën e të dhënave. Veçanërisht, lënda ka për qëllim të njoftojë studentet në lidhje me aspektin fizik dhe logjik të bazës së të dhënave dhe të aftësojë ata që në mënyrë të pavarur, duke përdorur në praktikë teknologjinë informatike dhe kompjuterike, të menaxhojnë të dhënat në bazën e të dhënave. Studentët do të përdorin softuerin për menaxhimin e bazës së të dhënave dhe do të njihen me disa trende aktuale të organizimit dhe deponimit të dhënave në baza të lidhura me web, hypermedia, baza të dhënave multidimensionale etj.

Menaxhimi i Cilësisë (Z): 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët pas përfundimit të kursit do të jenë në gjendje: të shfrytëzojnë të dhënat statistikore, interpretimin e tyre, dhe me anë të tyre të bëjnë studimin e dukurive shoqërore, ekonomike, natyrore etj. Të bëjnë paraqitjen grafike të dhënave.

Analiza dhe Dizajnimi i Sistemeve [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të njoftohen me analizat dhe dizajnimin e Sistemeve të ndryshme që janë pjesë e proceseve biznesore duke përfshirë sistemin më të nevojshëm për një biznes – sistemin e informacionit. Të njoftohen me procedurat analitike dhe dizajnuese të këtyre sistemeve dhe implementimin e sistemeve në fushën e prodhimit të produkteve apo shërbimeve.

E - Biznesi [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është studentët të njoftohen me konceptet e duhura të disa modeleve bashkëkohore të zhvillimit të biznesit elektronik: B2B, B2C, C2C, C2B. Do të njoftohen me konceptet e tregtisë elektronike (E-commerce), e-marketing, e-banking, të njoftohen me proceset biznesore të realizuara përmes teknologjisë së informacionit e veçanërisht përmes internetit ose në mënyrë elektronike.